

SHKOLLAT E MESME TË PËRGJITHËSHME

PROFILI NATYROR

**PJESA I
LETËRSI**

ISMAIL KADARE: KRISTAL

Ka kohë që s' shihemi dhe ndiej
Si të harroj un' dalngadal,
Si vdes tek unë kujtimi yt
Si vdesin flokët dhe gjithçka.

Tani kërkuj unë posht' e lart
Një vend ku ty të të lëshoj.
Një strofë a notë, a një brilant
Ku të të lë, të puth, të shkoj.

Në s' të pranofte asnjë varr
Asnjë mermer a morg kristal,
Mos duhet vall' prap të të mbart
Gjysmë të vdekur, gjysmë të gjallë?

Në s' gjetsha hon ku të të hedh
Të gjej një fushë a një lulënjë
Ku butësisht porsin polen
Gjithkund, gjithkund të të shpërndaj.

Të të mashtroj ndoshta kështu
Dhe të të puth e t' ik pa kthim.
Dhe nuk do dimë as ne, askush
Harrim ish ky a s' ish harrim.

Matura Shtetërore 2006, Teste

Për pyetjet 1-5 rretho vetëm shkronjën përbri përgjigjes së saktë.

1. Kjo poezi bën pjesë në lirikën: **1 pikë**
A) filozofike.
B) të natyrës.
C) intime.
D) shoqërore.
2. Prej dashurisë që nuk është më, heroi lirik ndahet me: **1 pikë**
A) delikatesë dhe dhimbje.
B) ftohtësi dhe mospërfillje.
C) brutalitet dhe zemërim.
D) lot dhe ankime.
3. Atë çfarë përcjell kjo poezi te lexuesi është se: **1 pikë**
A) dashuria e humbur duhet harruar.
B) asnjë dashuri nuk humbet.
C) një dashuri është si gjithë të tjerat, zëvendësohet shpejt.
D) dashuria e humbur zëvendësohet me shpërfillje.
4. Ndjenja që zotëron në këtë poezi është: **1 pikë**
A) ironia.
B) urrejtja.
C) zhgënjimi.
D) nostalgjia.
5. Kjo poezi është shkruar me varg: **1 pikë**
A) 6 - rrokësh.
B) 8 - rrokësh.
C) 10 - rrokësh.
D) 12 - rrokësh.
6. Pse autori ka vënë në titull të poezisë metaforën *kristal*? Gjej disa nga ngjashmëritë fizike, estetike etj. ndërmjet kristalit dhe dashurisë së humbur. Shkruaj mendimin që të lind nga krahasimi i saj me këtë gur të çmuar. **4 pikë**

Letërsi dhe gjuhë shqipe, sesioni I

7. Rendit tre tipare të lirikës erotike të Kadaresë, duke u ndalur në poezinë e mësipërme si dhe duke patur parasysh krijimtarinë poetike të autorit. **3 pikë**
- a. _____
- b. _____
- c. _____
8. Gjej detajet që duket sikur vizatojnë peizazhin e shpirtit të heroit lirik. Si do ta përcaktoje një shpirt të tillë: të bukur, të trazuar, të pakuptueshëm, të pasur, të dyshimtë, ...? Shpreh mendimin tënd duke shfrytëzuar detajet që gjete. **4 pikë**
9. Cilën nga fjalët e poezisë do të vendosje menjëherë pas fjalëve *hon* dhe *hedh*, duke pasur parasysh aliteracionin me shkronjën *h*? Ç'efekt krijon përmendja e menjëhershme pas tyre e fjalës *lulënjë*? Argumento mendimin tënd. **3 pikë**
10. Lexo me vëmendje dy vargjet e para të strofës së fundit. Si e kupton vargun *Dhe të të puth e t'ik pa kthim*? Në cilën prej dy fjalëve - kyç gjejmë të fshehur dhimbjen? Shpreh mendimin tënd në formën e një eseje argumentuese. **6 pikë**

PJESA II

SHEKSPIR: MAKBETHI AKTI II - SKENA I

Hyn Makbethi dhe një shërbëtor me pishtar

BANKOJA

..... Kush është atje?

MAKBETHI

Një mik

BANKOJA

Si, s'paske rënë edhe? Mbreti fjeti.
Ish i gëzuar fort dhe doroviti
Të gjithë shërbëtorët e kështjellës,
Këtë diamant ia dhuron zonjës sate,
Me falënderje për gostin' e bukur;
Dhe shkoi në shtrat pa masë i
kënaqur.

MAKBETHI

Nuk ishim përgatitur për vizitën;
Rob i mungesës ish vullneti ynë,
Se ndryshe do shfaqej më lirisht.

BANKOJA

Jo vajti mirë. Pashë në ëndërr
mbrëmë
Të tria motrat magjistrica
Një fjal' e tyre t'është vërtetuar.

MAKBETHI

S'mejtohem më për to, po kur të
duash,
E bisedojmë punën me pak fjalë,

Kur të kesh nge.

BANKOJA

Kur t' urdhërosh.

MAKBETHI

Në më përkrahç mejtimin, në
qëlloftë,
Ke për të pasur një shpërblim
me nder.

BANKOJA

Nuk e humbas, kur dua të rrit
nderin,
Po me ndërgjegje dhe
besnikëri;
Mund ta mejtojmë.

MAKBETHI

Natën e mirë, pra!

BANKOJA

Të falem nderit, mirëvafsh!
(*Dalin Bankoja dhe Fleanci*)

MAKBETHI

I thuaq zonjës, kur të ma
gatitë pijen
T'i bjerë ziles. Shko e fli
pastaj.
(*del shërbëtori*)

A është kamë, kjo që shoh përpara
Me dorezën nga dora ime? Pa ta
kap!
S'të kap dot, po të shoh aty akoma.
Pamje fatale, s'je e ndjeshme,
Për dorën si për syrin? apo s'je
Veç kamë e mendjes, një krijesë e
rreme,
Që rrjedh nga trur' i nxehur e i
vvarë?
Të shoh akoma aqë formëshkoqur.
Sa kjo që zhvesh tani nga mylli.
Më prin për udhën ku po nisesha;
Dhe një të tillë vegël kam për të
përdorur.
A më gënjehet syri, nga të tjerat
ndjenja,
A syri vlen më tepër se ato.
Të shoh akoma dhe ke pika gjaku
Përmbi lepitkën, që s'i kishe ca më
parë.
S'ka kamë aty; kjo s'është veçse
vepra
E gjakshme që po m'i shfaqet syrit.
Tani natyra duket si e vdekur
Mbi gjysmëbotën dhe të liga ëndrra
ia turbullojnë gjumin perdevarur;
Magjia i mëshon Hekatës zbehtë
Dhe vrasja fishkëse e alarmuar
Prej gardianit ujk e kukuvajkës.

Që i troket sahatin, - kështu
niset
Ngadalë dhe çap hajdutërisht
E ndezur si Tarkini i hazdisur
Kundrejt qëllimit si ndonjë
fantazmë.
O dhé, i ngjeshur hekur,
themelfortë,
Mos i dëgjo ku më baresin
këmbët,
Se mos bërtasin gurët ku po
vete
Dhe ma rrëmbejnë kohën e
favortë
Për veprën e tmerruar të
tanishme.
Kur unë kërcënoj, ai po rron
Me fjalë ftoh zjarr vepre që
valon
(tingëllin një zile)
Po shkoj, dhe është bërë, zilja
po më fton,
Duncan, mos e dëgjo, se kjo
këmbanë
Po të thërret në qiell a ferr
hapsanë.
*(Makbethi del. Hyn Zonja
Makbeth)*

Fjalor:

Hekata - mbretëresha e nëntokës (mitologjia).

Këtu është kthyer në qenie ferri.

vrasja fishkëse - vrasësi i fishkur, i tharë, skelet

Tarkini i hazdisur - Tarkini VI i Romës, përdhunues.

Matura Shtetërore 2006, Teste

Për pyetjet 11-15 rretho vetëm shkronjën përbri përgjigjes së saktë.

- 11.** Për subjektin e “Makbethit”, Shekspiri u mbështet në: **1 pikë**
A) eposin e vendeve ballkanike.
B) romantizmin anglez.
C) ngjarjet e Skocisë mesjetare.
D) letërsinë kalorsiake.
- 12.** Në këtë vepër të Shekspirit, *tragjika* qëndron në: **1 pikë**
A) pamundësinë për të trashëguar kurorën.
B) transformimin e Makbethit në një vrasës ordiner.
C) numrin e madh të vrasjeve.
D) besimin e verbër të profecitë.
- 13.** Makbethi, ky njeri i veprimit, i patrembur e ambicioz, shquhet për: **1 pikë**
A) imagjinatën e gjallë.
B) etjen për drejtësi.
C) besnikërinë ndaj mbretit.
D) idealin humanist.
- 14.** Tragjedia “Makbeth” shquhet për: **1 pikë**
A) ndikimin nga folklori.
B) përmbysjen e papritur të situatave.
C) përdorimin e elementit të absurdit.
D) kompozicionin e përsosur.
- 15.** Në tragjedinë “Makbeth”, Shekspiri ka synuar të japë: **1 pikë**
A) aventurat e një njeriu për t’u bërë mbret.
B) filozofinë politike e historike të epokës.
C) një kronikë fantastike të luftës për pushtet.
D) paraqitjen natyraliste të një vargu krimesh.
- 16.** Dialogu ndërmjet Makbethit e Bankos në takimin e tyre pas mesnatës, kur të tjerët flenë pas gostisë, zbulon karakterin e dy gjeneralëve. Përshkruaj cilësitë e karakterit që shfaqin Makbethi me Bankon duke e ilustruar me vargje nga fragmenti. **4 pikë**

Letërsi dhe gjuhë shqipe, sesioni I

17. Përcakto *kohën* në të cilën zhvillohet dialogu midis Bankos dhe Makbethit. Cili është funksioni artistik i saj (i kohës)? **3 pikë**
18. Në dy vargjet e fundit është përdorur një figurë e intonacionit (e tingëllimit). Cila është ajo, funksioni që kryen dhe ndjenjat që nxit te lexuesi? **4 pikë**
19. Interpretë nëntekstin e fjalëve të Bankos në lidhje me magjistricat:
Një fjalë e tyre t'është vërtetuar. **3 pikë**
20. Si realizohet artistikisht në monolog ideja se vepra kriminale, që do të kryejë, i shkakton Makbethit një luftë të tendosur psikologjike. Argumento përgjigjen. **6 pikë**